

të popullit tonë, ka kryer me sukses detyrat e saja për mbrojtjen e atdheut.

Për asnjë çast nuk duhen harruar armiqtë e vendit tonë dhe tentativat që bëjnë imperialistët amerikanë e të tjerë për shpërthimin e një lufte të re.

Shokë ushtarë, nënoficerë, oficerë dhe gjeneralë,

Përvetësoni më tepër artin ushtarak, lartësoni nivelin tuaj politik dhe të jeni kurdoherë vigjilentë dhe të gatshëm për të mbrojtur fitoret e luftës dhe frutet e punës paqësore pesëvjeçare të popullit tonë, që është i vendosur përkrah kampit demokratik me në krye Bashkimin Sovjetik.

Ushtria jonë të jetë mburojë e fortë e atdheut dhe e popullit tonë paqedashës kundër nxitësve të një lufte të re, imperialistëve amerikanë, anglezë dhe satelitëve të tyre.

Ju përshëndes me rastin e pesëvjetorit të çlirimit dhe ju uroj suksese të reja për modernizimin e ushtrisë sonë.

Për krentimin e kësaj dite,

U r d h ë r o j :

Sot, në kryeqytetin e Republikës Popullore të Shqipërisë në Tiranë, në orën 9,30 të shtihen 10 breshëri artilerie dhe në qytetet: Korçë, Gjirokastër, Vlorë e Shkodër të shtihen 5 breshëri artilerie.

URDHER DITE ME RASTIN E PËRVJETORIT TË PESTË TË ÇLIRIMIT

29 Nëntor 1949

Shokë ushtarë, nënoficerë, oficerë dhe gjeneralë,

Sot populli dhe Ushtria Popullore festojnë pesëvjetorin e çlirimit të atdheut nga okupatorët nazifashistë dhe tradhëtarët e vendit. 29 Nëntori i 1944-s i dha fund një herë e përgjithmonë okupacionit dhe regjimit feudalo-borgjez në vendin tonë.

Viti i pestë i çlirimit, në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë e të ndihmës së sinqertë të Bashkimit Sovjetik, e gjen vendin tonë me suksese të mëdha. Populli ynë i bashkuar si një blok i vetëm nën udhëheqjen e drejtë e të sigurtë të Partisë e të qeverisë, ka vënë të gjitha forcat për realizimin me sukses të planit dyvjeçar dhe ecën i sigurtë në rrugën për ngritjen e bazave të socializmit.

Në vitet e pasluftës ushtria jonë ka korrur suksese të dukshme në pregatitjen e saj luftarake dhe politike sipas shembullit të Ushtrisë së lavdishme Sovjetike dhe artit ushtarak stalinian. Ushtria jonë, e frymëzuar nga ndjenja e lartë e patriotizmit dhe traditat luftarake

Rroftë përvjetori i pestë i çlirimit të atdheut tonë!
 Rroftë populli shqiptar!
 Rroftë Ushtria jonë Popullore!
 Rroftë Bashkimi Sovjetik dhe Gjeneralisimi Stalin!
 Rroftë kampi demokratik dhe antiimperialist!

Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të
 Armatosura të Republikës
 Popullore të Shqipërisë
 Gjeneral-Armate

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në
 gazetën «Zëri i Popullit»,
 Nr. 288 (361), 29 nëntor 1949

Botohet sipas tekstit të gazetës
 «Zëri i Popullit», Nr. 288 (361),
 29 nëntor 1949

TELEGRAM URIMI DËRGUAR J. V. STALINIT ME RASTIN E 70-VJETORIT TË DITËLINDJES

20 dhjetor 1949

GJENERALISIMIT STALIN
 KRYETAR I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BRSS

Kremlin-Moskë

Në emër të popullit shqiptar, të Qeverisë së RP të Shqipërisë dhe në emrin tim personal, me rastin e 70-vjetorit të ditëlindjes Suaj, ju urojmë nga zemra me plot dashuri, jetë të gjatë për të mirën dhe lumturinë e popujve sovjetikë, të gjithë popujve përparimtarë të botës dhe të popullit tonë.

Në ditën e 70-vjetorit Tuaj, ne kujtojmë me respektin më të madh, luftën Tuaj të lavdishme përkrah gjenisë së madhe të Leninit për triumfin e Revolucionit socialist të Tetorit dhe për ndërtimin e shtetit të parë socialist në botë, kujtojmë veprat Tuaja të pavdekshme si udhëheqës i shtetit sovjetik në rrugën e ndërtimit të socializmit dhe të komunizmit, udhëheqjen Tuaj të shquar në luftën kundër hordhive nazifashiste për mbrojtjen e Bashkimit të lavdishëm Sovjetik dhe për shpëtimin e botës nga mortaja fashiste, udhëheqësin e luftës të të gjithë popujve përparimtarë në luftën për